

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-078/14**

**Prishtinë,  
2 Dhjetor 2015**

Në çështjen juridike të

**S.S. (i përfaqësuar nga avokati M.Sh. )**

Rruga “Pariska Komuna nr. 2 A/3”

17500 Vranje

Serbi

***Pala ankuese***

**kundër**

**M.Sh. (i përfaqësuar nga avokati H.S. )**

Mustaf Koka 6

61000 Viti

***Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anders Cedhagen, dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/207/2013, lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) me numër KPA01152 më 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 dhjetor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.S. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 të datës 11 qershor 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA01152.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 i datës 11 qershor 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA01152.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 16 tetor 2007, S.S. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e banesës me sipërfaqe prej 63 m<sup>2</sup> që ndodhet në rrugën “Car Dusana”, Komuna e Vitisë (të tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Në kërkesë pala ankuese ka thënë se prona e kërkuar është humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/99, duke cekur 1 janar 1999 si datë të humbjes.
3. Bashkë me kërkesën pala ankuese ka dorëzuar edhe dokumentet në vijim:
  - Planin vjetor të Ndërmarrjes /Fabrika e mobileve “VINEX D.D” (në tekstin e mëtejme: VINEX D.D) për nevoja banimi të punëtorëve, nr. 732, të datës 22 gusht 1994 përmes së cilit është vendosur për nevojat e punëtorëve të përmendur si më poshtë: Ankuesi si Drejtor Ndhimës për çështje administraive dhe të personelit dhe dy punëtorë të tjerë.
  - Vendimin për ndarje nr. 2005 të lëshuar nga “VINEX D.D” më 30 dhjetor 1994 përmes së cilit “VINEX D.D” ia ka ndarë pronën e kërkuar punëtorit të tij, palës ankuese.
  - Kontratën për dhënie me qira të banesës, nr.2071 e lidhur në mes të Ndërmarrjes/Fabrikës së Mobileve “VINEX D.D” dhe palës ankuese më 10 janar 1995.
  - Kërkesën për blerjen e banesës me pronësi shoqërore Nr. 2077 më 11 janar 1995 të dorëzuar nga pala ankuese në “VINEX D.D” përmes së cilës kërkon blerjen e pronës së kërkuar në bazë të nenit 39 dhe 47 të Ligjit për Banim të Republikës së Serbisë.

- Kontratën për blerjen e banesës Vr.147/95 e datës 25 janar 1995 e lidhur në mes të “VINEX D.D” në cilësinë e shitësit dhe palës ankuese në cilësinë e blerësit të pronës së kërkuar.
- Autorizimin e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale të Vranjes Vr. 7661/07 më 25 shtator 2007 përmes së cilit pala ankuese e ka autorizuar M.Sh. n që ta përfaqësojë para AKP-së lidhur me banesën e cila ndodhet në Viti.
- 4. Më 24 qershor 2008, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës e cila ka rezultuar të jetë e zënë nga M.Sh. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), i cili ka marrë pjesë në procedurë pranë AKP-së.
- 5. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur dokumentet në vijim:
  - Vendimin për ndarje nr. 529 të lëshuar nga “VINEX D.D” të datës 22 nëntor 1976 përmes së cilit Ndërmarrja ia ka ndarë pronën e kërkuar palës përgjegjëse në ankesë.
  - Kontratën nr.524/2 të lidhur më 21 dhjetor 1976 në mes të “VINEX D.D” dhe palës përgjegjëse në ankesë, përmes së cilës “VINEX D.D” ia ka ndarë pronën e kërkuar palës përgjegjëse në ankesë.
  - Procesverbalin e “VINEX D.D” nr. 1910 të datës 10 shtator 1994 lidhur me gjendjen e banesës pas largimit të palës përgjegjëse në ankesë.
  - Aktgjykimin nr.29/92 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë, e datës 16 mars 1992, ku kërkesa për ndërprerjen e kontratës për qiranë e banesës është miratuar dhe pala përgjegjëse në ankesë është urdhëruar ta lirojë banesën.
  - Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. 199/92 më 30 qershor 1994, përmes së cilit ankesa e palës përgjegjëse në ankesë është refuzuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë është konfirmuar.
  - Vendimi nr. 5447/94 i lëshuar nga Gjykata Supreme e Serbisë, më 3 tetor 1995 përmes së cilit aktgjykimi nr.29/92 i Gjykatës Komunale të Vitisë dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. 199/92 janë anuluar dhe lënda është kthyer në shkallë të parë për rigjykim.
  - Padia e palës përgjegjëse në ankesë e paraqitur pranë Gjykatës Komunale të Vitisë më 19 janar 1996 për dëbim të jashtëligjshëm të banuesit.
  - Autorizimin nr.1047/08 të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale të Vitisë, më 3 korrik 2008, ku pala përgjegjëse në ankesë e ka autorizuar avokatin H.S. që ta përfaqësojë pranë AKP-së lidhur me lëndën nr.KPA01152.
- 6. Sipas raporteve verifikuese të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, asnjë nga dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk janë verifikuar si origjinale.
- 7. Më 11 qershor 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/R/207/2013, e refuzoi kërkesën. Në paragrafin 37-38 në vendimin grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar zbatohet në veçanti për kërkesën, thuhet se dokumentet të

cilat i ka dorëzuar pala ankuese, nuk janë verifikuar si origjinale nga Sekretaria Ekzekutive. KKPK-ja gjeti se pala ankuese nuk e ka vërtetuar të drejtën e tij të ligjshme ndaj pronës së kërkuar.

8. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 29 nëntor 2013, dhe ankesa është paraqitur më 27 dhjetor 2013.
9. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pranuar vendimin e KKPK-së më 6 nëntor 2013. Ai ka paraqitur përgjigje në ankesë.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

10. Pala ankuese pretendon se KKPK-së ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe gjithashtu ka bërë shkelje të gabuara dhe serioze të së drejtës materiale dhe procedurale.
11. Pala ankuese ka deklaruar se AKP-ja ka thënë se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë ndonjë nga dokumentet e dorëzuara nga ai. Sipas palës ankuese, Sekretaria Ekzekutive asnjëherë nuk ka kërkuar nga ai për dokumente origjinale ose fotokopje të vlefshme të origjinalit, edhe pse ai i ka thënë zyrtarëve të Sekretarisë Ekzekutive se i posedon të gjitha dokumentet origjinale.
12. Për këtë arsye pala ankuese beson se është bërë vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i fakteve nga çka ka rezultuar vendimi i KKPK-së.
13. Pala ankuese në ankesë jep një prezantim të detajuar të dokumenteve që i ka paraqitur me qëllim të vërtetimit të së drejtës së tij pronësore.

#### **Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë**

14. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se Ndërmarrja/Fabrika e Mobileve “VINEX D.D” ia ka ndarë atij pronën e kërkuar në vitin 1976, të cilën ai e ka poseduar dhe e ka shfrytëzuar në vazhdimësi me familjen e tij dhe bashkëshorten deri në dëbimin nga regjimi serb.
15. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale të Vitisë lidhur me pronën e kërkuar, por që procedura nuk ka përfunduar asnjëherë me aktgjykim të plotfuqishëm. Prandaj, sipas palës përgjegjëse në ankesë, të dy, Vendimi nr. 2005 i datës 30 tetor 1994 dhe kontrata e blerjes e lidhur në mes të palës ankuese dhe Ndërmarrjes janë të paligjshme dhe nuk mund të vërtetojnë asnjë efekt ligjor, sepse vendimi i mëparshëm për ndarje përmes së cilit Ndërmarrja e njëjtë ia ka ndarë pronën e kërkuar palës përgjegjëse në ankesë, nuk është shpallur i pavlefshëm apo pa forcë ligjore.

**Arsyetimi ligjor**

16. Pas shqyrtimit të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) dhe nenin 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar. Arsyetimi për këtë konkluzion ndodhet në vijim.
17. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se Sekretaria Ekzekutive ka bërë verifikimin negativ të dokumenteve, në të cilat pala ankuese e ka bazuar kërkesën e tij pronësore. Sekretaria Ekzekutive nuk ka qenë në gjendje të sigurojë *ex officio*, ndonjë provë në të cilën mbështetet kërkesa e palës ankuese. Në bazë të kësaj, KKPK-ja gjeti se pala ankuese nuk ka arritur të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës kontestuese.
18. Ankesa e palës ankuese përsërit pretendimet e njëjta që ai i ka bërë pranë KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është dorëzuar bashkë me ankesë.
19. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të drejtë dhe të plotë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk kishte shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të gabuar të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
20. Në bazë të të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3. nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

21. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

***Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit******Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it******Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it******Urs Nufer, Referent i EULEX-it***